

Human Rights Watch vë në mëdyshje llogaridhënien e OKB-së

■ NË KËTË NUMËR

Ministria ua sqaron Buxhetin OJQ-ve **2**

"Miss Kosova", një aktivitet i shëmtuar **2**

Prezantimi i donatorëve FDI **3**

Si të shkruhet një projekt i suksesshëm **3**

CSS-a avokon për sistem transporti më të mirë **3**

FDI: Konkurs për grante **3**

Transparency International prezanton doracakun antikorrupsion në Serbi **4**

Artikull i huazuar: Arritjet dhe dështimet në Administratën Ndërkombëtare **4**

■ NGJARJET E ARDHSHEME

Afati i grateve të FDI-së **15 mars.**

Diskutim Publik: Mjaft dhe KAN - Iniciativat Qytetare në Kosovë dhe Shqipëri..... **5 mars, 16:00.**

Trajnim: Qytetari aktiv dhe vullnetarizmi **6 mars, 10:00-16:00.**

Demonstrata për ndryshim të sistemit zgjedhor **8 mars, afër Selisë së UNMIK-ut, 12:00**

Fred Abrahams, shkrimtar dhe ish-hulumtues në Ballkan, kohët e fundit vizitoi Prishtinën për të shkruar një dokument strategjik mbi shkallën në të cilën Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) po i përmbush detyrimet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për qytetarët e Kosovës.

Human Rights Watch beson se, krahasuar me standardet ndërkombëtare, në Kosovë ekzistojnë shkeljet e të drejtave të njeriut lidhur me gjyqësorin, minoritetet, transparencën, përgjegjshmërinë dhe personat e zhdukur. Human Rights Watch brengoset sidomos që UNMIK-u ka tepër pushtet, por jo mjaft transparencë, përgjegjësi dhe llogaridhënie. "Strukturat qeverisëse në Kosovë janë si një labirint bizantin me dyer në Prishtinë, në selitë OKB-së dhe bile edhe në Beograd. Është e lehtë të humbësh rrugën në

një labirint të tillë dhe t'ia gjuash fajin njëri-tjetrit", tha ai. Abrahams sugjeroi që qytetarët të kërkojnë përgjegjshmëri duke ndryshuar ligjet dhe rregulloret.

Sipas Abrahams, OJQ-të mund të luajnë rol jetësor duke ushtruar presion tek autoritetet kosovare dhe UNMIK-u. Ai sugjeroi që OJQ-të të mbledhin fakte dhe informata në mënyrë profesionale dhe të përipiqen t'i kuptojnë ligjet dhe rregulloret. Ka dy lloje të avokimit për të sjellë ndryshime sipas Abrahams: avokim i qetë dhe avokim publik. "Avokimi i qetë" nuk është medeoemos sekret; ai përfshin hartimin e ligjeve, këshillimin me autoritetet dhe punën në bashkëpunim me strukturat qeverisëse. "Avokimi publik" është kritizimi publik, të cilit Abrahams i referohet si stili "emëroje dhe turpëroje". Këtu OJQ-të përdorin shtypin, konferencat dhe buletinet për të treguar paraktikat korru-



Abrahams ka punuar në rajon që nga viti 1992. Ai njihet më së miri për raportimin e tij mbi shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Tani, ai është duke e përfunduar një libër mbi Shqipërinë pas-komuniste, një pasqyrë e hollësishme e akterëve politikë dhe ngjarjeve nga viti 1990.

ptuese të individëve ose institucioneve.

Abrahams sugjeroi që OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare të bashkëpunojnë në përpjekjet e tyre avokuese. OJQ-të kanë informata të mira, kanë kontakte dhe e njohin kontekstin; ato e kuptojnë politikën dhe kulturën. Strukturat ndërkombëtare kanë kontakte në qeverinë e SHBA-ve, OKB-së dhe OSBE-së. Ndërkombëtarët po ashtu e kuptojnë kontekstin ndërkombëtar dhe kanë reputacion të lartë. "Për shembull, raporti ynë përfundimtar mund të botohet edhe në New York Times dhe ndikimi është automatikisht më i madh" tha ai.

"Strukturat qeverisëse në Kosovë janë si labirint bizantin."

ATRC-ja promovon qasjen e lirë në dokumente zyrtare

Të udhëhequr nga Article 19 dhe të përkrahur nga Komisioni Evropian, OJQ-të nga Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi filluan një projekt rajonal mbi Lirinë e Informimit në janar. Article 19, organizatë udhëheqëse Evropiane e cila punon për të promovuar qasje të lirë në informim në tërë botën, ka mbledhur organizatat e suksesshme të Evropës Jug-Lindore për të promovuar të drejtat e qytetarëve për qasje në informata që mbahen nga qeveritë e tyre. ATRC-ja

është përgjegjëse për zbatimin e projektit të Lirisë së Informimit në Kosovë.

Ligji mbi Qasjen në Dokumente Zyrtare sapo është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe nënshkruar nga Administratori i OKB-së në nëntor të vitit 2003. Ligji lejon që të gjithë qytetarët të kërkojnë dokumente zyrtare nga autoritetet. Po ashtu kërkon nga autoritetet që t'i japin informatat e kërkuara. Sipas ligjit, përjashtim bëjnë vetëm dokumentet e ndjeshme. Projekti i ATRC-së do të synojë të inkurajojë zbatimin e ligjit duke ngritur

vetëdijen e publikut dhe të OJQ-ve për mënyrën e shfrytëzimit efektiv të ligjit.

"Ligji është vendimtar për krijimin e një qeverie transparente, demokratike dhe jo sekrete", tha Kreshnik Berisha, drejtor i ATRC-së. "Megjithatë, sipas ligjit, Misioni i OKB-së në Kosovë (UNMIK), autoriteti më i lartë qeverisës në Kosovë, mban pushtet të pakufizuar për bërjen ose jo publike të dokumenteve të disponueshme. Kjo është kundër parimeve të transparencës të promovuar nga ky ligj nëpër botë", shtoi ai.



FDI-ja ofron udhëzime për përfituesit potencialë të Granteve

Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI) ishte i ftuari i dytë i ATRC-së në ciklin "Prezentimi i Donatorëve". FDI-ja financohet vetëm projekte avokimi dhe inkurajon koalicionet dhe projektet e antikorrupsionit. Grantet prej 4.000 deri 40.000 euro janë të disponueshme për: fushata avokimi; ndërhyrje strategjike (anti-korrupsion ose analiza të politikave publike) dhe trajnime.

Amy Horton nga Qendra Ndërkombëtare për Ligjin Jo-profitabil (ICNL) pyeti rreth kriterëve të FDI-së për organizatat, duke përfshirë mënyrën se si i menaxhojnë të hollat, sa gjatë kanë ekzistuar, nëse kanë kod të mirënjohjes apo çfarë është misioni i tyre. Drejtori ekzekutiv i FDI-së Bashkim Rrahmani tha që të gjitha këto konsiderohen gjatë shqyrtimit të aplikacionit. "Formularët e aplikimit mund të ndihmojnë dorëzimin e projekteve," tha ai. FDI-ja po ashtu takohet me OJQ-të për të ofruar informata mbi kriteret e projektit tha Rrahmani. FDI-ja ka themeluar një komision për shqyrtimin e granteve të përbërë nga personeli i fondacionit dhe antarët e bordit për të shqyrtuar grantet pas çdo raundi aplikimi.

Për të ilustruar kriteret e hartimit të projekteve, Muhamet Veliu nga Victoria Co dhe përfituesit e tjerë të granteve paraqitën projektet e tyre të aprovuara nga FDI-ja. Ata po ashtu diskutuan sukseset dhe sfidat e projekteve të tyre.

FDI-ja është partneri primar zbatues i Projektit të OJQ-ve Kosovare në Avokim (KNAP), një marrëveshje bashkëpunimi mes USAID-it dhe Institutit për Menaxhim Lindje-Perëndim (EWMI). FDI-ja ka themeluar sisteme të dhënies dhe regjistrimit të granteve që përputhen me standardet perëndimore. Së bashku me ATRC-në, përkrahja operationale, tërheqja e fondeve, rrjetëzimi dhe mundësia e mentorimit të FDI-së ka ndihmuar në transformimin e OJQ-ve nga ofrues shërbimesh në agjentë të ndryshimeve.



Përfaqësuesit e Ministrisë shpjegojnë Buxhetin e Kosovës

ATRC-ja ka mbajtur një trajnim buxheti për OJQ-të me ndihmën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF) në Qeverinë e Kosovës. Trajnimi ofron informata themelore rreth procesit të buxhetit të Kosovës; krahasoi procesin e buxhetit të Kosovës me modelet ndërkombëtare dhe u asistoi OJQ-ve për kuptimin e procesit të buxhetit. Përmes trajnimit, ATRC-ja ka shpresuar të ndërtojë kapacitetin e OJQ-ve për edukimin e qytetarëve se sa fonde përmban buxheti dhe pikat hyrëse për të ndikuar në të. Pjesëmarrësit e trajnimit po ashtu kanë pasur mundësi për të diskutuar çështjet e buxhetit me përfaqësuesit e MEF-it.

"Procesi i buxhetit në Kosovë është krejt ndryshe nga vendet e tjera; është kryesisht ekzekutiv, çka nënkupton që parlamenti nuk përfshihet në proces", shpjegoi Steven Leeds nga MEF.

Derisa Ministria fillon hartimin e buxhetit për vitin e ardhshëm në Prill, ndryshimet bëhen në mes të secilit vit kur shtohen të hollat.

Prandaj, pas ri-shqyrtimit të buxhetit, MEF-i kërkon nga komunat dhe ministrinë e tjera që të propozojnë projekte shtesë. Gjatë shqyrtimit të gjashtë-mujorit, OJQ-të mund të ndikojnë në prioritetet buxhetore të ministrive dhe komunave.

"A mund të kenë OJQ-të ndikim në ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjshmërisë?" pyeti Fron Nazi, Drejtues i KNAP-it. Ekzistojnë dy lloje të ligjeve buxhetore, tha Leeds. Së pari, ligji themelor rregullon procesin e planifikimit buxhetor çdo vit; ligji themelor nuk ndryshon. E dyta, ligji vjetor përcakton ndarjen e buxheteve vjetore për secilën organizatë buxhetore; ligji vjetor ndryshon çdo vit. Parlamenti harton dhe aprovon ligjin vjetor. Prandaj OJQ-të mund të ndikojnë në ligjin vjetor përmes Parlamentit dhe Qeverisë.

"Sa i hapur është procesi para se të bëhet publik



Stephen Leeds dhe Agim Krasniqi sqarojnë buxhetin OJQ-ve kosovare

buxheti në dhjetor? Si mund ta shoh se si janë shpenzuar tatimet e mia?", pyeti Kimete Klenja nga ATRC-ja. Ligji ekzistues përcakton se si duhet të ndahen fondet dhe gjobat pasuese nëse nuk është ndarë si duhet. Strukturat, si auditimi, po ashtu ekzistojnë, por nuk janë zbatuar, u përgjigj Leeds.

Pjesëmarrësit e tjerë ngritën pyetje lidhur me publikimin në media të suficitit buxhetor prej 330 milionë euro i cili më vonë zbriti në 75 milionë euro. Llogaritja e suficitit ishte bërë sipas të hollave të mbetura në bankë; shumë nga këto projekte janë të aprovuara por të vonuara për vitin 2004, sqaroi Agim Krasniqi.

Qytetarët kërkojnë nga Ministria të publikojë shpenzimet e "Miss Kosova"

Përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës të cilët kanë shfrytëzuar fondet publike për përkrahjen e bizneseve vendore në organizimin e "Miss Kosova" nuk ishin të pranishëm në debatin e ATRC-së me temën "Figura e femrës dhe gara e bukurisë në Kosovë" në datën 11 shkurt. Pjesëmarrësit e debatit e akuzuan Ministrinë për dështim në shpërndarjen e dhuratave të premtuara, mos bërjen publike të fitimeve potenciale financiare dhe parregullsisë të tjera financiare lidhur me garën. Ata kërkuan që Ministria të bëjë publike shumën e të hollave të shpenzuara dhe çfarëdo lloj përfitimi financiar që rrjedh nga "Miss Kosova".

"Prezantimi i bukurisë mes nesh bëhet përmes një

aktiviteti shumë të shëmtuar," tha profesori Kadri Metaj nga Universiteti i Prishtinës. Folësit e tjerë të ftuar në diskutim ishin Luljeta Krasniqi, albanologe dhe veprimtare për të drejtat e grave e cila ka botuar kohët e fundit një artikull mbi këtë çështje dhe Adem Gashi nga Ministria e Kulturës, i cili nuk u paraqiti.

Krasniqi diskutoi dobësitë e garës dhe rolin e gruas në të. Ajo vuri në mëdyshje mungesën e kriterëve të moshës për pjesëmarrësit e "Miss Kosova", e cila i lejon vajzat e mitura të garojnë, aftësinë e pjesëmarrësve të reja për të bërë vendime të matura lidhur me pjesëmarrjen e tyre në këtë ngjarje dhe paraqitjen e tyre lakuriqe e cila ndonjëherë konsiderohet si përfaqësues

i "bukurisë" së tyre.

"Në këtë garë "femra" është bërë objekt i përqeshjes. Ajo nuk ka emër dhe identitet, vetëm një tabelë me numër rreth qafës" tha Luljeta Krasniqi. Në vend se të paraqiten vlerat, ndodh e kundërta në këtë "spektakël të organizuar nën patronatin e institucioneve më të larta që merren me çështjet kulturore," tha ajo.

Pjesëmarrësit e diskutimit shprehën brengosjen rreth organizimit të "Miss Kosova", paraqitjes së vlerave në raport me femrat dhe rolin e Ministrisë së Kulturës në këtë veprimtari. Çështja tjetër e rëndësishme e diskutuar nga pjesëmarrësit ishte raporti mes publikut të rritur dhe moshës së re të pjesëmarrësve të garës.

FDI shpall konkursin për grante

Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI) i fton OJQ-të kosovare të aplikojnë për grante të Projektit të OJQ-ve Kosovare në Avokim (KNAP). KNAP është marrëveshje tre-vjeçare bashkëpunimi mes USAID-it dhe Institutit për Menaxhim Lindje-Perëndim (EWMI). Do t'u jepet prioritet projekteve të parashtruara nga OJQ avokuese dhe grupe ekspertësh. FDI-ja i inkurajon aplikuesit të propozojnë qasje inovative në punën me media për të rritur ndikimin e aktiviteteve të propozuara. Grantet prej 4,000 deri 40,000 euro janë të disponueshme për anti-korrupsion, analiza të politikave publike dhe aktiviteteve avokuese. Aplikacionet duhet të dorëzohen deri më datën 15 mars. Për informata të mëtejshme dhe formularë aplikimi, ju lutemi kontaktoni:

FDI

**rr. Besim Bishtazhini, 12
Gjakovë, Kosovë
Tel: 044-222-568
fdigjakova@hotmail.com**

SHARRI-NET kremton dy-vjetorin e ekzistimit

Sharri-net, i njohur si Rrjeti i Organizatave Mjedisore Kosovare festoi përvjetorin e tij të dytë duke mbajur një koktej dhe duke treguar një video prezantim. Qëllimi i takimit ishte që OJQ-të të nënshkruajnë një memorandum të mirëkuptimit dhe të bëhet prezantimi i kodit të mirësjelljes. Përfaqësuesit nga Sharri-net kanë shpërndarë letra mirënjohjeje për anëtarët e rrjetit dhe i përgëzuan ata për arritjet e tyre në fushën e mjedisit. Rrjeti përbëhet nga 17 organizata mjedisore nga e tërë Kosova.

Si të shkruhet një projekt i suksesshëm

Amy Horton nga Qendra Ndërkombëtare për Ligjin Joprofitabil (ICNL) dhe Gjyljeta Mushkolaj nga Instituti Kosovar për të Drejtën e OJQ-ve (IKDO) udhëhoqën një punëtor për OJQ-të e interesuara për të aplikuar për fonde tek Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI). Punëtorja paraqiti udhëzime se si të shkruhet një projekt-propozim për zbatimin e rregullores për pjesëmarrje publike në kuvendin komunal.

"Pse duhet të jenë OJQ-të të interesuara për këtë? Disa nga ju mund të mendojnë se ndoshta projekti ishte i suksesshëm në disa komuna, por nuk do të ketë sukses në komunën tuaj," ishin disa prej brengave të përfaqësuesëve të adresuara nga Horton. "Megjithatë, FDI-ja kërkon të financojë një projekt të tillë, nëse ua dëshmoni atyreve se do të keni sukses," tha ajo.

ICNL dhe IKDO kanë punuar tashmë me OJQ-të vendore për të hartuar modele që shpiejnë kah aprovimi i rregullores për pjesëmarrje publike në

qytete të tjera. Gjatë punëtorisë OJQ-të diskutuan se si mund të përshtatet ky projekt sipas rrethanave individuale të komunës. Horton theksoi se OJQ-të duhet t'i hartojnë projektet e tyre sipas nevojave specifike të komunës së tyre. Ajo po ashtu i inkurajoi ato që këtu të përfshijnë idetë e tyre kreative dhe unike.

"Ju si OJQ mund të keni projektin më të mirë në botë, por jo objektiva të qarta [...] donatori nuk do të rrezikojë në këtë rast. Paraqiteni veten si profesionistë dhe lini përshtypje" këshilloi Horton.

Gjatë punëtorisë Horton dhe Mushkolaj u munduan të nxjerrin nga pjesëmarrësit komponentët e rëndësishëm të propozimit. Ato ilustruan në hollësi dallimin diskret mes cakt të përgjithshëm, objektivave dhe aktiviteteve, pasi shumë OJQ i ngatërronjë këto komponente: caku është rezultati përfundimtar ose pika kryesore e ndikimit, të cilin dëshiron dikush ta arrijë. Objektivat



Amy Horton dhe Gjyljeta Mushkolaj u afrojnë OJQ-ve teknika për shkrimin e granteve për projektin mbi pjesëmarrjen publike në vendim-marrje

janë ndryshimet në sjelljen e grupeve të synuara që shërbejnë drejt arritjes së cakt të projektit. Aktivitetet janë veprime specifike të ndërrmarra për të realizuar objektivat dhe cakun.

Më specifikisht, Horton dhe Mushkolaj diskutuan rëndësinë e të paturit një cak të qartë, të arritshëm dhe të matshëm (rezultat) dhe aktivitete të përcaktuara qartë që hartohen për të arritur cakun. Duke shfrytëzuar si shembull projektin e pjesëmarrjes publike, ato përkshkruan caqet dhe objektivat (pjesëmarrje më e madhe publike me aprovimin e rregullores; edukimin e qytetarëve rreth saj; dhe zbatimin).

Qytetarët avokojnë për transport më të mirë publik në Prizren

Qendra për Shoqëri Civile (CSS) prezantoi projektin e vet të ri "Komuniteti dhe Vendim-marrja" në diskutimin publik të 12 shkurtit në Kuvendin Komunal të Prizrenit. Ekspertët ligjorë, të ekonomisë dhe të komunikacionit i sqaruan OJQ-ve, qytetarëve dhe përfaqësuesëve të qeverisë lokale rëndësinë e pjesëmarrjes publike në vendim-marrje. "Proceset e mirëfillta demokratike nuk mund të imagjinohen pa pjesëmarrjen e qytetarëve," tha Xhevdet Mekani nga CSS-ja.

CSS-ja ka dhënë një konferencë për shtyp, ka anketuar rreth 140 qytetarë, ka publikuar fletushka dhe ka takuar grupe qytetare, persona me ndikim dhe OJQ. Kjo ka rezultuar në nënshkrimin e memorandu-

mit nga 14 OJQ vendore. Përmes këtij projekti, CSS-ja shpreson të hartojë një rregullore ose t'i shtojë amendamente rregulloreve ekzistuese për të lejuar një linjë mini-busësh në rrjetin e transportit publik të Prizrenit. Synimi është të zgjidhen problemet siç janë rrëmujat në trafik, mungesa e parkingjeve, rrugët e ngushta, ndotja e ajrit, rrugët anësore të bllokuara nga makinat dhe shpenzimet e larta të transportit.

Sipas projekt-rregullores, tarifa e shërbimit do të ishte 0.30 Euro për udhëtim dhe linjat do të përshkonin qytetin. "Qytetarët do të përfitojnë financiarisht nga ky projekt derisa shërbimet e tjera si taksitë ose makinat private kanë çmime të larta" tha Anton Çetta, ekspert i

ekonomisë. Ndërsa një ekspert ligjor dhe i komunikacionit konfirmuan pjesëmarrjen e tyre, por nuk u paraqitën.

Drejtori i Komunikacionit në Komunën e Prizrenit dyshton në sigurinë e mini-busave, sidomos për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe fëmijët. Ai sugjeroi një projekt pilot gjashtë-mujor për të testuar efikasitetin e sistemit transportues të propozuar.

Teuta Luzha nga Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI), organizata e cila financon projektin e CSS-së, sugjeroi që komuna të parashikojë fonde për zgjerimin e rrugëve të Prizrenit në buxhetin e vitit 2004. Zgjerimi i rrugëve do të mundësojë një sistem më funksional transporti, tha ajo.

Transparency International prezanton doracakun anti-korrupsion në Serbi

BEOGRAD, 4 shkurt 2003 - një doracak mbi hapat praktikë që duhen ndërmarrë në secilin sektor të shoqërisë për luftimin e korrupsionit është publikuar në datën 4 shkurt në gjuhën serbe në një ngjarje të veçantë në kryeqytetin Beograd.

Publikimi, Libri i Burimeve TI 2000: Përballimi me Korrupsionin: elementet e Sistemit për Integritet Kombëtar, paraqet konceptin e Sistemit Integruer Kombëtar. Kjo i qaset anti-korrupsionit jo vetëm nga këndi i luftimit por edhe nga këndi i prandalimit dhe edukimit.

Versioni serb i doracakut është përgatitur nga rrjeti serb i organizatave joqeveritare, Transparency International, bashkë me Agjencinë e Lajmeve Beta dhe me përkrahjen e Misionit të OSBE-së në Serbi dhe Mal të Zi.

Sistemi, po ashtu, përcakton kornizën shumë-nivelëshe me 11 shtylla ku shtrihet lufta kundër korrupsionit. Kjo përfshin pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ, gjyqësorin, Zyrën e Prokurorit Publik, policisë, shërbimeve publike, Auditorin e Përgjithshëm, agjencitë e anti-korrupsionit (komisionet), Ombudspersonin,

mediat dhe shoqërinë civile.

Doracku anti-korrupsion po ashtu përmban dokumentimin e praktikave më të mira dhe mjeteve praktike që mund të shfrytëzohen për të luftuar kundër praktikave korruptuese.

Folësit kryesorë në prezantimin e doracakut ishin: Ambasadori Maurizio Massari, shef i Misionit të OSBE-së; Profesori Vladimir Goati, Kryetar i Transparency Serbia; Nemanja Nenadic, udhëheqës i projektit Transparency Serbia; dhe Zlatko Minic, Redaktor Interneti në Agjencinë e Lajmeve Beta.

Rr. Agim Ramadani Nr. 15
(ish Ramiz Sadiku)

Kati i dytë
Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 38 244 810

Fax: +381 38 244 810

Email: atrcknap@yahoo.com

Drejtor

KRESHNIK BERISHA
keka@advocacy-center.org

**Menaxhere e
Përgjithshme**

KIMETE KLENJA
kimete@advocacy-center.org

Menaxhere e Trajnimeve

NATYRA ZHJEQI
natyra@advocacy-center.org

**Përgjegjëse për
Informim dhe**

Marrëdhënie me Publik
NICOLE FARNSWORTH
nicole@advocacy-center.org

**Koordinatorë për
Informim dhe**

Marrëdhënie me Publik
DAFINA ZHERKA
dafina@advocacy-center.org

Administrator Zyre
GANI ASLLANI

gani@advocacy-center.org

Artikulli i huazuar: Zëri

Arrijet dhe dështimet e Administratës Ndërkombëtare

Që nga viti 1999, e shohim OKB-në si bartës të procesit të ndërtimit të shoqërisë demokratike në Kosovë, duke pritur periudhën kur do të zgjidhet statusi final i Kosovës. Vendet perëndimore ishin gati të këmbëjnë përfundimin e shpejtë dhe të suksesshëm të luftës me inkuadrimitin e OKB-së si instancë përgjegjëse për paqen kosovare. Mirëpo, vetëm disa prej tyre i besuan iluzionit se OKB-ja mund të funksionojë si duhet në Kosovë.

Mbase problemi më i madh i UNMIK-ut është vetë fakti që është UNMIK. UNMIK-u, një organizëm i OKB-së, i cili edhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë ende është në kërkim të identitetit të tij; një protektorat joformal - një mision pa afat kohor dhe mandate të qarta lidhur me çështjen kryesore - statusin final të Kosovës; UNMIK-u është strukturë e cila varet në masë të madhe nga ushtarët e NATO-s, të hollat e BE-së, raportet mes SHBA-ve dhe vendeve kryesore të BE-së dhe vendimet e marra nga Grupi i Kontaktit - instancë më relevante për zgjidhjen e statusit final të Kosovës.

Siç e dimë të gjithë, UNMIK-u ka kompetenca të mirëfillta vetëm mbi shqiptarët e Kosovës. Politikanët serbë në Ko-

sovë dhe regjimi serb në Beograd nuk e përfillin fare atë. Kjo është ilustruar me ekzistencën e strukturave paralele serbe në Kosovë. Këto struktura vazhdojnë të ekzistojnë përkundër apeleve publike të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Kofi Annan dhe Shefit të UNMIK-ut Harri Holkeri për t'u shpërbërë.

UNMIK-u ka përgjegjësi të rezervuara në siguri, çështjet e pakicave, gjyqësor, politikën e jashtme, ekonomi (privatizim, etj.). Çfarëdo analize serioze e rezultateve të kësaj administrate, e cila ka kompetenca në segmentet kyçe të qeverisë, do të nxirrte në shesh konkludimin që UNMIK-u ka patur më shumë dështime se suksese. Pas një lufte dy-vjeçare dhe një vakumi institucional tetë-mujor, shoqëria Kosovare ka pasur nevojë për një Administratë Ndërkombëtare e cila do të ndihmojë jo vetëm me rindërtimin e Kosovës së dëmtuar nga lufta por edhe në krijimin e institucioneve për një shoqëri të mirëfilltë demokratike. Pesë vjet pas luftës, UNMIK-u ka më tepër pushtet se sa është pritur pesë vjet më parë, dhe më shumë se sa që e meriton. Cilësia e dobët e pushtetit lokal nuk mund të shërbejë si justifikim për mbajtjen e monopolit nga

ana e UNMIK-ut.

Rrugëdalja nga kriza evidente në funksionimin e raporteve mes Administratës Ndërkombëtare dhe pushtetit vendor shihet në "Standardet për Kosovën". Tani do të themelohet një partneritet, dhe implementimi i planit të detajuar pritet të fillojë. Megjithatë, prej tani vërehen një mori problemesh të cilat do ta mëdyshin procesin. Së pari, Beogradi dhe politikanët serbë në Kosovë i kundërshtojnë standardet. Prapë, pa angazhimin e tyre të sigurtë në proces, ideja perëndimore e rezultateve nga standardet e cila thekson trajtimin e pakicës serbe, do të jetë shumë e vështirë të arrihet.

Nuk do të ketë befasi. UNMIK-u dhe Kosovarët do të vazhdojnë të rrokullisen edhe pas shkurtit 2004. Harri Holkeri nuk do të jetë administratori i fundit në Kosovë. UNMIK-u do të jetë në Kosovë edhe pas 1 janarit 2006. Situata në Kosovë mund të ndryshojë vetëm përmes iniciativave të politikanëve dhe institucioneve lokale. Deri më tani nuk ka pasur asnjë shenjë se iniciativa të tilla janë të mundshme.

(Kjo shtojcë speciale në "Zërin e Ditës" u përgatit me ndihmën e Komitetit Suedez të Helsinkit.)

Biblioteka eATRC-së



600+ tituj